

Sinjalizime

# Të shtëna me armë pas një konflikti në Prishtinë, Policia bastis shtëpinë e 25-vjeçarit



Sinjali.com

06 Korrik 2026 09:34



**Të shtëna me armë zjarri janë raportuar pasditen e së dielës në kryeqytet, pas një mosmarrëveshjeje mes disa personave, ndërsa një 25-vjeçar po hetohet për armëmbajtje pa leje dhe përdorim të armës, raporton Sinjali.**

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se rasti ka ndodhur rreth orës 17:30, në rrugën *“Jeronim De Rada”* në Prishtinë.

Sipas informacioneve të para, pas një konflikti verbal, ankuesi B. G rreth 37 vjeç ka deklaruar se i dyshuari Shpërblim Mehmeti 25-vjeç kishte nxjerrë një armë zjarri dhe dyshohet se kishte shtënë me të. Në incident është përfshirë edhe Beqir Gashi rreth 58 vjeç.

Të gjitha palët janë shoqëruar në Stacionin Policor për intervistim.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitë e hetimeve, forenzikës dhe Njësia për Hetimin e Krimeve të Përgjithshme, ku është gjetur dhe sekuestruar një gëzhjojë, e cila dyshohet se është shkrepur nga arma e përdorur në incident.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit është kryer edhe bastisja e shtëpisë së të dyshuarit, por gjatë kontrollit nuk është gjetur asnjë send i dyshimtë.

Ndaj Shpërblim Mehmetit është iniciuar procedurë penale për veprat *“Armëmbajtje pa leje”* dhe *“Përdorim i armës”*, ndërsa hetimet për zbardhjen e plotë të rastit janë në vazhdim.

**Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.**

***Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!***


***/GazetaSinjali/***

Prishtinë

Policia

bastisje

## Të tjera:




**Ekskluzive | Arrestohet edhe i dyshuari i pestë për grabitjet me thikë në Prishtinë – përfundon ...**

**Sinjalizime**



**Punimet te Rrethi i Flamurit, Trafiku Urban njofton devijimin e linjave 3 dhe 4**

**Kosovë**



**Alarm në Prishtinë, zhduket 13-vjeçarja – familja kërkon ndihmë për ta gjetur**

**Siguri**



**Ekskluzive | 19-vjeçarit i gjenden marihuanë dhe thikë gjatë kontrollit policor në Prishtinë,...**

**Ekskluzive**



**31 vjet nga masakra e Srebrenicës, Prishtina e shënon me një aksion**

**Kosovë**



**Gjendet një mjet shpërthyes në Prishtinë, Policia evakuon qytetarët – në terren...**

**Siguri**



**17 raste me fruth në Prishtinë, Hashani bën thirrje për vaksinim të fëmijëve**

**Shëndetësi**



**“Fëmija hyn në të”, puseta e hapur në rrugë në Kodrën e Trimave në Prishtinë po rrezikon...**

**Siguri**

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



### Lajme

Zgjedhjet 2026  
Kosovë  
Shqipëri  
Rajon  
Diasporë  
Evropë  
Botë

### Aktualitet

Politikë  
Drejtësi  
Siguri  
Shëndetësi  
Arsim  
Sociale

### Hulumtime

Ekskluzive  
Profile  
Skandaloze

### Ekonomi

Prodhime Vendore  
Financa  
Biznes

### Sport

Botërori 2026  
Futboll  
Basketboll  
Sporte Luftarake  
Sporte të tjera

### Showbiz

Bota e Yjeve  
Modë & Stil  
Bukuri dhe kujdes  
Të tjera

### OP-ED

Analizë  
Kolumne  
Intervistë

### Jetë

Fitness  
Ushqime  
Travel  
Këshilla  
Receta  
Dieta  
Shëndeti

### Kulturë

Film  
Muzikë  
TV & Radio  
Libra  
Art & Dizajn  
Fotografi  
Histori

### Tech & Auto

Teknologji  
Automjete  
Telefona  
Internet  
Lojëra  
Aplikacione

### Fun

Qesharake  
Kuriozitete  
Kuize  
Fakte  
Të tjera